DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-33/1
-VI- Data Datum Date 06.02.2019

# Republika e Kosovës

## Republika Kosovo - Republic of Kosovo

**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*

*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*

*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për : | Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovë<br>Anton Shala, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës | |
| Cc: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | Venera Çerkini, u.d i Drejtorit të Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL | Datë:<br>21.01.2019 |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Gjakovës | Nr.020-33 |
| Lloji i aktit: | ☐ Vendim | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-40 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim nr. 01-463/02-33033/18 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se komunës Kompanisë së Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Kosovë sh.a. (KEDS) |
| I miratuar më datë: 04.12.2018 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 14.01.2019 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës ***në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi***. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALSE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020 - 33/1
-VI- Data Datum Date 06.02.2019

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| **Za:** | Ardian Gjini, gradonačelnik opštine Đakovica<br>Anton Shala, predsedavajući Skupštine opštine Đakovica | |
| **Kopija:** | Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS<br>Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini | |
| **Preko:** | Ivan Todosijević, ministar MALS-a,<br>Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a | |
| **Od:** | Venera Çerkini, v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i nadgledanje opština, MALS | Dana: 21.01.2019.<br>Br. 020-33 |
| **Predmet:** | Potvrda zakonitosti akta opštine Đakovica | |
| **Vrsta akta:** | Odluka | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

| |
|---|
| Odluka br.01-463/02-33033/18 za davanje opštinske imovine na dugoročno korišćenje Kompaniji za distribuciju električne energije na Kosovu, sh.a. (KEDS). |
| Usvojena dana: 04.12.2018. godine |
| Dostavljena MALS-u za razmatranje dana: 14.01.2019. godine |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt ***sa proceduralnog aspekta u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi.*** Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

HYRESE-ULAZNA-INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum: 14-01-2019
-01- 020-33

Kuvendi i Komunës - Gjakovë
01.Nr. 463/02-2843 2018
Dt. 04.12.2018

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 10 paragrafi 1.5 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, në mbledhjen e mbajtur me dt.04.12.2018, pas diskutimeve lidhur me pikën e 7-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesave për dhënien në shfrytëzim të pronës së Paluajtshme Komunale KEDS-it për vendosjen e 3 Trafostacioneve në Fshatin Doblibare dhe 1 në fshatin Marmull, e miratoi këtë:

**V e n d i m**

**Për dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim**

1. Aprovohet kërkesa e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në kohëzgjatje prej 99 vite pa kompensim material, në pjesën e ngastrës kadastrale me numër 1026-0, ZK Doblibare, P.SH. Rrugët Publike, për vendosjen e Trafostacionit të tipit Shtyllë, me dimensione (2.0 x 2.0)m², me sipërfaqe prej S= 4.0 m.

2. Autorizohen organet e administratës komunale që të ndjekin procedurat ligjore për dhënien në shfrytëzim KEDS-it pronën Komunale të theksuar në pikën e 1-rë të këtij Vendimi.

3. Komuna në çdo kohë mund ta kthej në gjendjen e mëparshme pronën e cekur në pikën e 1-rë të këtij Vendimi, në rastet e shpalljes së interesit të përgjithshëm për realizimin e Planeve Rregulluese Urbane dhe Projekteve Komunale që janë në interes të qytetarëve.

4. Në obligimet e KEDS të parashihet gjithsesi investimi edhe në rehabilitimin e rrjetit në vendbanimin (lagjen) ku i është dhënë prona komunale në shfrytëzim për vendosjen e TS-it.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

6. **Vendimi iu dërgohet:**
   - Z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
   - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
   - Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
   - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë
   - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
   - Arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Shpresa Shala

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Kuvendi i Komunës - Gjakovë**
**01.Nr.463/02-33035 /2018**
**Dt. 04.12.2018**

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 10 paragrafi 1.5 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, në mbledhjen e mbajtur me dt.04.12.2018, pas diskutimeve lidhur më pikën e 7-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesave për dhënien në shfrytëzim të pronës së Paluajtshme Komunale KEDS-it për vendosjen e 3 Trafostacioneve në Fshatin Doblibare dhe 1 në fshatin Marmull, e miratoi këtë:

## V e n d i m
## Për dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim

1. Aprovohet kërkesa e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në kohëzgjatje prej 99 vite pa kompensim material, në pjesën e ngastrës kadastrale me numër 1013- 4, ZK Marmull, P.SH. Pasuri e Fshatit, për vendosjen e Trafostacionit të tipit "Shtyllë", me dimensione (2.0 x 2.0) $m^2$, me sipërfaqe prej S= 4.0 $m^2$.

2. Autorizohen organet e administratës komunale që të ndjekin procedurat ligjore për dhënien në shfrytëzim KEDS-it, pronën Komunale të theksuar në pikën e 1-rë të këtij Vendimi.

3. Komuna në çdo kohë mund ta kthej në gjendjen e mëparshme pronën e cekur në pikën e 1-rë të këtij Vendimi, në rastet e shpalljes së interesit të përgjithshëm për realizimin e Planeve Rregulluese Urbane dhe Projekteve Komunale që janë në interes të qytetarëve.

4. Në obligimet e KEDS të parashihet gjithsesi investimi edhe në rehabilitimin e rrjetit në vendbanimin (lagjen) ku i është dhënë prona komunale në shfrytëzim për vendosjen e TS-it.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës .

6. **Vendimi iu dërgohet:**
   - Z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës.
   - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
   - Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit .
   - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
   - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
   - Arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z. [illegible] Shala

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

| | |
|---|---|
| Data: | 21.11.2018 |
| Nr.lëndës: | 07/353/01-30503 |
| Për: | z. Anton Shala, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës |
| CC: | Kryetarit të Komunës z. Ardian Gjini |
| Nga: | Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtori: Arben Bakalli |
| Lënda: | Propozim-Vendim |

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke ju referuar kërkesës së parashtruar nga "KEDS" Distrikti në Gjakovë të bazuar në nenin 26 dhe 28 të Ligjit për Energjinë Nr.05/L-081, lidhur me çështjen e dhënies në shfrytëzim të pronës publike komunale, me qëllim të vendosjes së Trafostacionit të tipit Shtyllë, me dimensione (2.0 x 2.0)$m^2$, me sipërfaqe prej S=4.0 $m^2$, në pjesën e ngastrës kadastrale me numër 1013 – 4, ZK Marmull, P.SH. Rrugët Publike, në bazë nenit 55, paragrafi "m" të Statutit të Komunës së Gjakovës, nenit 10 pika 1.5 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës Nr.04L-144 si dhe nenit 20 pika 11 të "Rregullores Nr.23/2013 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe Këmbim të pronës së Paluajtshme të Komunës", kërkon nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës që të miratoj këtë:

**P R O P O Z I M**

**Për marrjen e Vendimit për dhënien e pronës Komunale në shfrytëzim**

1. Kuvendi i Komunës aprovon kërkesën e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në kohëzgjatje prej 99 vite pa kompensim material, në pjesën e ngastrës kadastrale me numër 1013- 4, ZK Marmull, P.SH. Pasuri e Fshatit, për vendosjen e Trafostacionit të tipit "Shtyllë", me dimensione (2.0 x 2.0) $m^2$, me sipërfaqe prej S= 4.0 $m^2$.

2. Autorizohen organet e administratës komunale që të ndjekin procedurat ligjore për dhënien në shfrytëzim KEDS-it, pronën Komunale të theksuar në pikën e 1-rë të këtij vendimi.

3. Komuna në çdo kohë mund ta kthej në gjendjen e mëparshme pronën e cekur në pikën e 1-rë të këtij Vendimi, në rastet e shpalljes së interesit të përgjithshëm për realizimin e Planeve Rregulluese Urbane dhe Projekteve Komunale që janë në interes të qytetarëve.

4. Në obligimet e KEDS të parashihet gjithsesi investimi edhe në rehabilitimin e rrjetit në vendbanimin (lagjen) ku i është dhënë prona komunale në shfrytëzim për vendosjen e TS-it.

**Me respekt !**


Postal address: Nëna Tereze 181 Gjakovë, Kosovë
Tel: +381 390 322-452, 530 070,525 059 Fax: +381 390 322 452
www.gjakova-komuna.org

TRAFOSTACIONI (TSSH) NË MARMULL: NGASTRA NR.1013-4 ZK MARMULL



Z.K. Marmull
Nr. Parc. 1013-4 PSH PASURI E FSHATIT

## PLAN SITUACIONI

PËR VENDOSJEN E TSSH ME DIMENSIONE TË BAZAMENTIT 2.0 m X 2.0 m




LOKACIONI PËR TSSH
Pozita: X: 7459566.565
Y: 4692695.645

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
*Qeveria -Vlada-Government*
*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGECIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT \ KOPIJA PLANA \ COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija \ Municipal Cadastral Office : GJAKOVË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona \ Cadastral Zone : Marmull

| Njësia \ Jedinica \ Unit | Tipi \ Vrsta \ Type | Sipërfaqja \ Površina \ Area m² |
|---|---|---|
| P - 70705048 - 01013 - 4 | Parcelë \ Parcela \ Parcel | 3317.0 |




Shkalla / Razmera /Scale: 1:2500

Punoi \ Obradio \ Created :
Data \ Data \ Date : 18.10.2018
Koha \ Vreme \ Time : 09:25:15
Nënshkrimi \ Potpis \ Siganture:
Shënim \ Beleška \ Note :

Aprovoi \ Usvojio \ Aproved : Drejtori \ Direktor \ Director
Nënshkrimi \ Potpis \ Siganture:

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70705048-01013-4

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 127/08-k-1 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 27.09.2018 - 10:24 |
| Komuna / Opština / Municipality: | Gjakovë / Djakovica / Gjakove |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | MARMULE / MARMULE / MARMULE |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | Gjakovë / Djakovica / Gjakove |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type | Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type | Zona U/R G/S U/R | Sipërfaqja Površina Area (m²) | Përshkrim Opis Description | Krijuar më datën Urađeno na dan Created On | Azhurnuar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-70705048-01013-4 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqerore / Društvena imovina / Socially owned Land | Rural | 3317 | | 27.09.2018 | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa Prebivalište - adresa Resident - address | Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code | Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address Details | Krijuar më datën Urađeno na dan Created On | Azhurnuar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|
| KOMASACION/KOMASACION/KOMASACION | | | | 27.09.2018 |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA — Komuna e Gjakovës — Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Arat/Njive/Arable | Arë E Klasës 2/Njiva 2 Klase/2nd Class Arable Land | 1738 |
| | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Arat/Njive/Arable | Arë E Klasës 3/Njiva 3 Klase/3rd Class Arable Land | 1579 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhurnar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | PSH.PASURI E FSHATIT | KCID9713395 | MARMULLE / MARMULLE / MARMULLE / | | | 1/1 | | 27.09.2013 |

# THEMELI PËR TRAFOSHTYLLË






| | |
|---|---|
| KEDS | |
| Themeli prizmatik i betonit për trafoshtyllë | DIVIZIONI I RRJETIT<br>Departamenti për Investime<br>Sektori për Planifikim dhe Projekte |
| Përpjesa: | Data: 02/2015 |
| Investitori: | KEDS Sh.a. |
| Lokacioni: | Prishtinë |
| Punoi: | Hava Maloku tek.el |
| Kontrolloi: | Nezir Boshtraj, inxh.el.i dip. |
| Projekti: | Nr. i fletës: B-1 |

KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE SH.A.
KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION AND SUPPLY COMPANY J.S.C.
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA DISTRIBUCIJU I SNABDEVANJE ELEKTRIČNOM ENERGIJOM D.D.
KEDS - SH. A.
Nr. 2243 dt. 05 NOV 2018
GJAKOVË

KEDS

| | |
|---|---|
| Për: | Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit KK Gjakovë - Arben Bakalli Drejtor, Lulzim Haxhiu – Udhëheqës i sektorit |
| Nga: | Burim Gërqina Inxhinier i Rrjetit Distrikti Gjakovë |
| Përmes: | Agnez Furra, Drejtor Distriktit, Gjakovë – KEDS |
| Data: | 05.11.2018 |
| Lënda: | Kërkesë për shfrytëzimin e hapësirës publike në fshatin Marmull |

Të nderuar,

Duke qenë se kemi ardhur afër fazës së fillimit të punimeve në realizimin e projekteve të planifikuara për vitin 2019 në regjionin e Gjakovës, ju drejtohemi me këtë kërkesë për shfrytëzimin e hapësirës publike në fshatin Marmull ku do të vendoset objekti elektroenergjetik – trafostacioni shtyllë me konstruksion metalik, me dimensione të bazamentit: 2.0 m x 2.0 m = 4.0 $m^2$

Ky trafostacion do të shërbejë për furnizim më të mirë me energji elektrike të konsumatorëve të fshatit Marmull në kuadër të projektit të rikonstruimit të rrjetit elektrik.

Bashkëngjitur është kopja e planit, lista poseduese për ngastrën kadastrale nr.1013-4 P.Sh. Pasuri e fshatit, Z.K. Marmull, plansituacioni i lokacionit të trafos dhe kërkesa nr.1323 e datës 31.07.2017 e Drejtorisë për Shërbime Publike të KK Gjakovë për rregullimin e rrjetit elektrik të fshatit Marmull në bazë të kërkesës së komunitetit të atij fshati.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritashëm, mbetemi me shpresë se do të kemi përgjigje pozitive nga ana e Juaj.

Gjakovë, 05.11.2016

Me respekt

Drejtori i Distriktit Gjakovë

Agnez Furra

KEDS SH.A. GJAKOVË

Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Pranuar - Primljeno 05.11.18
01-353/01- 30503

2287 07 NOV 2018

KEDS

| | |
|---|---|
| Për: | Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit KK Gjakovë – Arben Bakalli Drejtor, Lulzim Haxhiu – Udhëheqës i sektorit |
| Nga: | Burim Gërqina Inxhinier i Rrjetit Distrikti Gjakovë |
| Përmes: | Agnez Furra, Drejtor Distriktit, Gjakovë – KEDS |
| Data: | 07.11.2018 |
| Lënda: | Plotësim kërkese për shfrytëzimin e hapësirës publike në fshatin Doblibare dhe Marmull |

Të nderuar,

Ju drejtohemi me këtë kërkesë që shfrytëzimi i hapësirës publike në fshatin Doblibare dhe Marmull për lokacionet ku do të vendoset objekti elektroenergjetik – trafostacionet të jetë afatgjatë - në afat 99 vjet dhe pa pagesë në Fshatin Doblibare:

Ngastra nr.770-0 PSH Rrugët Publike Z.K. Doblibare
Ngastra nr.1026-0 PSH Rrugët Publike Z.K. Doblibare
Ngastra nr.1026-0 PSH Rrugët Publike Z.K. Doblibare (Kulla)

dhe në Fshatin Marmull:
Ngastra nr.1013-4 PSH Pasuri e Fshatit Z.K. Marmull

Këto trafostacione do të shërbejnë për furnizim më të mirë me energji elektrike të konsumatorëve të fshatit Doblibare dhe Marmull në kuadër të projektit të rikonstruimit të rrjetit elektrik.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritashëm, mbetemi me shpresë se do të kemi përgjigje pozitive nga ana e Juaj.

Me respekt

Drejtori i Distriktit Gjakovë

Agnez Furra

Ndërtesa e Elektrokosovës
Bulevardi Bill Klinton nr.3
Prishtinë 10000
Republika e Kosovës

# PËRFORCIMI DHE ZGJERIMI I RRJETIT NË TU 2018
# DISTRIKTI I GJAKOVËS

## REKONSTRUIMI I DALJEVE 0.4 KV TË MBINGARKUARA NË FSHATIN MARMULL

## PËRSHKRIMI TEKNIK I RRJETËS

Për shkak të vjetërsisë së rrjetit distributiv dhe rrezikut që mund ti kanoset komunitetit si dhe mbingarkesës për shkak të rritjes së konsumit në këtë rrjetë, është paraparë rikonstruktimi i rrjetit ekzistues në mënyrë që të rritet kualiteti dhe siguria e energjisë elektrike për këtë lagje/rajon.

Rrjeta e tensionit të ulët (TU) 0.4 kV do të zëvendësohet me shtylla të betonit me gjatësi 9[m] dhe për degët magjistrale të TU 0.4 kV kemi kabëll vetëmbajtës KVM X00/0-A 3x70+71.5 mm$^2$, ndërsa nëndegët janë gjithashtu me kabëll KVM X00/0-A 3x50+71.5 mm$^2$, X00/0-A 3x35+71.5 mm$^2$.

Rrjeta e tensionit të mesëm (TM) 10(20) kV do të zëvendësohet me shtylla betoni me gjatësi 12[m]. Për LP 10(20)kV ajror do të punohet me përçuesit AlFe 3x50/8 mm$^2$.

Rikonstruktimi përfshin tri (Trafostacione) TS ekzistues, njëri TS ekzistues do të zhvendoset në shtyllë të betonit dhe një TS i ri në konstruksion metalik.

Njehsorët do të zhvendosen në shtylla.

## TË DHËNAT THEMELORE PËR DREJTIMIN

| | |
|---|---|
| Tensioni nominal | 0.4 kV |
| Lloji i objektit | Ajror |
| Kablli, tipi dhe materijali | ABC kabëll bistek , PP00 |
| Gjatësia e rrjetit ajror 0.4 kV | 5700 m |
| Shtyllat e betonit | 84 copë |
| Lloji i objektit | Ajror |

| | |
|---|---|
| Tensioni nominal | 10(20) kV |
| Lloji i objektit | Ajror |
| Përquesi, tipi dhe materijali | Al-Fe, 20kV |
| Gjatësia e rrjetit ajror 10(20) kV | 2700 m |
| Shtyllat e betonit | 84 copë |
| TSSH 10(20)/04 kV / Fuqia | 100kVA, 2x160kVA, 250kVA |

1684

SHERBIMET PUBLIKE

Nga: Këshilli I fshatit Marmullë

Përë: KES-CO – Gjakovë

Lënda : **Kërkesë për mbeshtetje te projektit**
**Ndrimi i rrjetit te energjise elektrike( shtyllave te drurit)**
**për fshatin Marmullë**

Të nderuar
Banorët e fshatit Marmullë përmes perfaqsuesëve të tyre ( këshillin e ketij fshati ), Ju njoftojne se gjendja e te gjitha shtyllave te rrjetit elektrik nga materia drurore ( shtyllat e drurit) jane shume te damtuara, meqe qe nga vuarja e tyre nga vitet e 60-ta e gjer me tani nuke ka patur intervenime adekuate
Teknikisht sistemi elektrik eshte mjafte i mire mirepo qdo here kure situata metereologjike eshte e ndryshueshme sidomos gjat fryerjes se eerave te gjitha shtyllat drurore sjellin ramjen e sistemit energjetik apo shkaktohet nderprerje shume e rende e rrymes, si pasoi e kesaj dukurie banoret e fashatit perballen me mungese te energjise elektrike per dite te tera, gjer ne intervenim nga ekipet e mirmbajtjes
Andaj nga arsyet e larte permendura banoret e ketij fshati kerkojne me **urgjence** qe te intervenohet ne ndrrim te te gjitha shtyllave te drurit dhe zavendesimi i tyre me ato te betonit derisa kushtet atmosferike lejojne nje gje te tille.
Ju njoftoi se gjate ndrrimit te shtyllave do te hasni ne perkrahje te vazhdueshme te banoreve dhe familjeve te ketij fshati ne menyre qe ky proces te kryhet si eshte me se miri dhe sa ma shpejt qe eshte e mundur, si dhe ekzekutimi te jete sa ma funksional.
Njekohesisht ju njoftojme se jemi te gatshem qe te pranojme edhe ndrrimin e rrjetit te energjise elektrike nga sistemi me tela ne ate kabllor-bistek i cili sistem parashef edhe vuarjen e oreve elektrike jasht objekteve te banimit pra ne shtylla te betonit ne menyre qe te ju mundesohet punetoreve te KES-CO monitorim dhe mbikqyrje sa ma efikase, njekohesisht edhe kontrol me efikase e harxhimit te energjise elektrike, po ashtu edhe lexim dhe fakturim ne baza mujore dhe transparente.
Duke shpresuar se kerkesa e jone do te hase ne mirekuptim Ju pershendesim paraprakisht

Ne emer te banoreve te fshatit Marmulle

Keshilli i fshatit Marmull

1. Gasper Gjugja 044-133-808
2. Nrec Marku
3. Engjell Gojani
4. Leonard Noka

Zef Shala
Bashkpunetor Profesional

Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrate
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove
Pranoj - Primljen
Pranuar - Primljeno dt. 13-02-12

| Njësia organiz. Org. jedinica | Numri Broj | Shtojca Prilozi | Vlera Vrednost |
|---|---|---|---|
| 07 | 352 | /011-1607 | 18 |

Republika e Kosovës / Komuna e Gjakovës / Opština Djakovica
Drejtoria për ...
Nr.08 357/01-16788
Data 26.07.2017
Gjakovë - Djakovica - Gjakova

KEDS - SH. A.
Nr. 1323 Data 27.07.2017
GJAKOVË

Republika e Kosovës
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

Komuna Gjakovë
Opština Djakovica
Municipal of Gjakova

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 26.07.2017 |
| PËR/ZA/TO: | Menaxherin z. Agnez Furra<br>KEDS – Gjakovë, Rr."M Teuta"<br>Gjakovë |
| CC : | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike-<br>Kaltrina Biblekaj ing.e ndërtimtarisë |
| NGA/OD/FROM: | Bashkëpunëtorë profesional për energji dhe ngrohje-<br>Ilhamije Kumnova ing.e dipl e elektrotek. |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Njoftim: Për kërkesën e dërguar nga Zef Shala –fshati Marmull |
| Nr. L./ Br. S./ No.S | |

Ju njoftojmë se kemi marr një kërkesë nga banorët e fshatit Marmull të cilën po ju përcjellim me ketë njoftim të dërguar nga Zef Shala drejtues i këshit të fshatit, në të cilën kërkohet që të bëhet zëvendësimi i shtyllave elektrike të drurit me ato të betonit.

Ju falënderojmë për bashkëpunim.

KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
Postal address: Nëna Tereze Gjakovë, Kosovë
Tel: +381 390 320 050
www.gjakova-komuna.org